



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe nenit 10 të Rregullorës për transportin e rregullt urbano-periferik të udhëtarëve me autobus 15Nr.344-4287 të datës 12.03.2013, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR NDARJEN E RENDEVE TË UDHËTIMIT TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS

Neni 1 Përbërja

Formohet Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e rendeve të udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus, (në vazhdim të tekstit Komisioni), sipas konkursit të rishpallur të datës 22.06.2016, në përbërje si vijon:

1. Behar Krasniqi, Zyra e Kryetarit, kryesues
2. Salihe Marevci, Drejtorati për Shërbime Publike, anëtare
3. Gafurr Hetemi, Zyra e Kryetarit, anëtar
4. Behar Mjeku, Drejtorati i Inspeksionit, anëtar
5. Anëtar i pestë caktohet nga Policia e Kosovës - Lipjan

Neni 2 Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë që të shqyrtoj aplikacionet e operatorëve të transportit të udhëtarëve me autobus, të cilët kanë aplikaur sipas konkursit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi për ndarjen e rendeve të udhëtimit.
2. Komisioni konform nenit 10 par. 5 të Rregullorës për transportin e rregullt urbano-periferik të udhëtarëve me autobus, pas shqyrtimit të aplikacioneve, harton propozimet konkrete për ndarjen e rendeve të udhëtimit operatorëve transportues, të cilët i plotisojnë më së miri kushtet e konkursit.
3. Propozimet nga paragrafi paraprak, Komisioni ia dërgon Drejtorit të Drejtoratit për Shërbime Publike për miratim dhe marrjen të Vendimit.
4. Punët ndihmëse administrative dhe teknike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Shërbime Publike.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 346-36084
Lipjan, më 07.07.2016



KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti